Në bazë të neneve 1, 2, 5, 6, 8, 9, 15.2.1 dhe 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), si dhe bazuar në Rregulloren nr.06/2023 për Rregullat e Përgjithshme të Tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve transaksioneve të Ndërmarrjeve Shoqërore SHAL 63, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet shitja e Njesisë nr.40: NSh "Sharrprodhimi" - Shitorja në fshatin Buçe, Dragash - R me ofertuese me çmim 5,000 €.
- II. Udhëzohet Menaxhmenti i AKP-së që asetin t'a tenderojë sërish në një fazë të mëvonshme sipas planit dinamik të Menaxhmentit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

A R S Y E T I M

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për transaksionet e SHAL 63.

Bazuar në Nenin 14.3.1 të Rregullave të Tenderit, pasi që çmimi i pranuar është më i ultë se çmimi orientues, është refuzuar shitja e këtij aseti.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Agjencia është e autorizuar që të ndërmerr veprimet të cilat Agjencia i konsideron të nevojshme për shitjen, transferimin apo zgjidhjen në mënyra tjera të një pjese apo tërë aseteve të ndërmarrjes /çdo aseti në kompetencat administrative të Agjencisë.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.



Menfor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-189/20

Në bazë të neneve 6.2.1, 6.2.3 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe bazuar Rregulloren nr.06-2023 për Rregullat e tenderit si dhe Procedurat e shitjes me tender publik, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së për aprovimin listës së aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në Likuidim që do të publikohen për shitje si SHAL 64 me depozita, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Azhurnohet lista e aseteve për shitje në SHAL 64 me gjithë depozitat e propozuara.
- II. Listës së SHAL 64 i shtohen asetet që nuk kanë pranuar oferta në SHAL 63, asetet që janë refuzuar (pika 5.1 e rendit të ditës) përveç aseteve të NSH Tefik Çanga - TokaT në Busi: LOT B, LOT C, LOT D, LOT E, LOT F, LOT G, dhe asetet e luajtshme të NSH Urata PRN103 (pika 8.6) e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje.
- III. Publikimi i SHAL 64 i parashikuar për datë 02 nëntor 2023 shtyhet për datë 09 nëntor 2023, rrjedhimisht edhe dita e shitjes mbahet me 29 nëntor 2023.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e trasakcioneve të SHAL 63 në këtë mbledhje, dhe pas diskutimeve në mënyrë që SHAL 64 të pasurohet me asete vendosi që listës së SHAL 64 t'i shtohen asetet që nuk kanë pranuar oferta në SHAL 64, asetet që janë refuzuar (pika 5.1 e rendit të ditës), dhe asetet e luajtshme të NSH Urata PRN103 (pika 8.6) e rendit të ditës të kësaj mbledhjeje. Ky vendim e plotëson vendimin nr.ref. BD-188-4 të datës 16 tetor 2023.

Në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, AKP ka zotësi të plotë juridike, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj.

Në këtë kontekst një ndër detyrat themelore të Agjencisë është procesi i shitjes së pronave shoqërore në mbarë territorin e Kosovës. Ndër format e shitjeve që përdorë Agjencia Kosovare e Privatizimit është shitja përmes tenderit publik dhe atë kryesisht nëpërmes grupimit të aseteve në Shitje të Aseteve përmes Likuidimit (SHAL). Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

HA

[illegible]

147



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-189/21

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Rregullorja nr.17/2023 për Autoritetin e Likuidimit mbi procedurat e prokurimit duke shfrytëzuar fondet e likuidimit në mirëbesim.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

Arsyetim


Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e aktit nënligjor sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Në vitin 2009 është aprovuar Udhëzuesi nr. 01/2009 për Autoritetin e Likuidimit mbi procedurat e prokurimit duke shfrytëzuar fondet e likuidimit në mirëbesim. Menaxhmenti duke parë nevojën për një draftimin e Rregullores për Autoritetin e Likuidimit mbi procedurat e prokurimit duke shfrytëzuar fondet e likuidimit në mirëbesim ka formuar grupin punues, i cili grup punues ka dhënë komentet/inputet në Definicionet dhe Rregullat, Parimet e Prokurimit dhe Procesin e Prokurimit që do të zbatohen për çdo prokurim të ndërmarr nga Autoriteti i Likuidimit duke shfrytëzuar fondet e likuidimit në mirëbesim.

Deri te draftimi i rregullores ka ardhur në bazë të nevojës që të përcaktohen Definicionet dhe Rregullat, Parimet e Prokurimit dhe Procesin e Prokurimit që do të zbatohen për çdo prokurim të ndërmarr nga Autoriteti i Likuidimit duke shfrytëzuar fondet e likuidimit në mirëbesim.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.


Mentor Hyseini
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-189/22

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Rregullorja nr.15/2023 e Divizionit të Shqyrtimit të Ankesave në Listat e 20% të Punëtorëve, e harmonizuar me me strukturën e re organizative dhe Rregulloren për organizimin e brendshme dhe sistematizimin e vendeve të punës**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e aktit nënligjor sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Me hyrjen në fuqi të strukturës së re organizative dhe Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës me datë 01 tetor 2023 është konsideruar e nevojshme që të azhurnohen procedurat punës, përkatësisht të harmonizohen me strukturën e re organizative dhe Rregulloren për organizimin e brendshme dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Azhurnimet në këtë akt nën ligjor janë të natyrës teknike si dhe qartësimi i procedurave të punës në harmoni me strukturën e re organizative dhe Rregulloren për organizimin e brendshme dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe plotësim-ndryshimi i rregullores është bërë në kuptim të asaj me qëllim të sqarimit të procedurave të punës duke i specifikuar se pas shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me ankesat e parashtruar në Listë, përgatitet dhe nënshkruhet Raporti i shqyrtimit të ankesave në Listat e 20% të punëtorëve, dhe krijohet Lista përfundimtare e punëtorëve për përfitimin e 20% të NSH-së, dërgimi i propozimit për aprovim të Listës përfundimtare të punëtorëve, të Bordi i Agjencisë, si dhe dërgimi i propozimit për aprovim të shpërndarjes së 20% pas aprovimit të Listës përfundimtare, dërgimi për publikim të Listës përfundimtare.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-189/23

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregulloren nr. 07/2023 për qiradhënien e aseteve të NSH-së, dhe Kontratën bazë të Qirasë me Nr. të protokollit 15033/2017 e dt. 23.01.2017 (të vazhduar), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet vazhdimi i kontratës me NeëCo "Ferronikeli Complex" L.L.C lidhur me asetën e NSH-së "MIM Golesh" PRN053 për periudhën 01 dhjetor 2023 deri më 30 nëntor 2024.
- II. Kontrata do të nënshkruhet në momentin që NeëCo "Ferronikeli Complex" L.L.C sjell sigurimin e kontratës në shumë prej 300,000.00 € siç parashihet me dispozitat ligjore në fuqi
- III. Në rast se pala nuk sjell sigurimin bankar sipas nenit II këtij vendimi atëherë kontrata nuk do të vazhdohet.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e kërkesës nga "NeëCo Ferronikeli Complex" L.L.C për vazhdimin e kontratës së qirasë.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se aseti përkatësisht toka/parcela 341-0 e cila ndodhet në zonën kadastrale Medvec të komunës së Lipjanit, pronë NSH MIM Golesh PRN053.. Shfrytëzuesi "NeëCo Ferronikeli Complex" L.L.C e ka në shfrytëzim parcelën 341/0 për disa vite në bazë të kontratës bazë së qirasë të datës 23.01.2017 me nr. protokollit 15033/2017 arovuar nga Bordi I AKP-së përmes vendimit Nr. Ref. BD -79/3. Kontrata është vazhduar disa herë nga Bordi, ndërsa aneksi i fundit i kontratës së qirasë është apvuar nga Bordi përmes vendimit Nr. Ref. BD-173/54 të datës 30.11.2022 dhe skadon më datë 30.11.2023.

Duke qenë se mandati i Agjencisë mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore dhe gjenerimit të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e Agjencisë dhe duke qenë se shfrytëzuesi ka përmbushur rregullisht obligimet kontraktuale që rrjedhin nga kontrata kanë kërkuar nga AKP gjegjësisht Bordi i Drejtorëve të ju mundëson vazhdimin e kontratës së qirasë. Shfrytëzuesit kanë cekur se për shkaqe të kompanisë së tyre dhe ndërrimit të aksionarëve në kompani nuk e kanë shfrytëzuar asetën/parcelën fare në këtë vit. në atë mënyrë që në rast se nuk do të bëhet kthimi në gjendjen e mëmparshme atëherë do të bëhet konfiskimi i garancionit bankar. Aneksi i rradhës do të nënshkruhet vetëm pasi që qiramarrësi sjellë dëshminë për vazhdimin e garancionit bankar edhe për një vit (01.12.2023 – 30.11.2024) sipas nenit II të dispozitivit të këtij vendimi.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org
ee.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-189/24

Në bazë të neneve 9 dhe 15.2.13 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenit 5 dhe 16 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të ndryshuar me nenin 20 të Ligjit 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Të iniciohen procedurat e likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet në datën e paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë edhe miratimin e buxhetit 2 vjeçar të likuidimit të vlerësuar për Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet një nga një, ndërsa shpenzimet e buxhetit realizohen në bazë të nenit 16 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndryshuar me nenin 20 të Ligjit 06/L-023 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Kategoria	Komuna	Regjioni
1	PRN202	Automakedonija	Aset	Prishtinë	Prishtinë
2	PRN206	Borba	Aset	Prishtinë	Prishtinë

- II. Autorizohet Menaxhmenti i AKP-së që të emëroj Autoritetet e Likuidimit (AL) për secilën Ndërmarrje Shoqërore/Aset nga pika (i) e Vendimit të Bordit (përfshirë çfarëdo zëvendësimi të kohëpaskohshëm);
- III. Miratohet shitja e të gjitha aseteve "Sipas ligjit dhe akteve nënligjore të AKP-së", të cilat janë të listuara në dokumentet "Përmbledhje për Bord" (Board Brief) për ndërmarrjet/asetet e propozuara për fillim të procedurave të likuidimit;
- IV. Vendimet për likuidim dhe fillimi i procedurave të likuidimit hyjnë në fuqi me datë 15 nëntor 2023.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe aprovoi sipas procedurave inicimin e procedurave të likuidimit për:

- a) **PRN202 Automakedonija** - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i këtij aseti ka qenë i shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së, Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Aseteve dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 28 korrik 2022 ka aprovuar raportin përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (KPS 1531), sipas nenit 5.1 të Ligjit Nr. 04/L-034). Në bazë të dokumenteve që posedon ZR Prishtinë, Organizata Punuese "Automakedonija" me seli në Shkup, Maqedoni e Veriut ka pasur filialë në Prishtinë, respektivisht lokalet afariste me sipërfaqe të përgjithshme prej 316.5 m² në ish rrugën "Ljeningova" nr. 5, tani e njohur si Bulevardi "Bill Klinton" në Prishtinë si dhe ngastrën kadastrale 1504/13, Zona Kadastrale Prishtinë.
- b) **PRN206 Borba** - Bazuar në analizën ligjore të dokumentacionit përkatës, statusi i këtij aseti ka qenë i shqyrtuar nga Zyra Rajonale e AKP-së, Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Asetit dhe sipas rekomandimit, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me datë 29 qershor 2023 ka aprovuar raportin

111



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

përfundimtar dhe rekomandimin e Komisionit dhe qëndrimi i tyre është se i njëjti bie nën administrimin e AKP-së (KPS 1534), sipas nenit 5.1 të Ligjit Nr. 04/L-034). Borba, aseti në Prishtinë përfshinë lokalitetin afarist me sipërfaqe 125.75 m² i cili gjendet në lagjen Dardania, Kurriz, nr. 5, Lamela 10, nr. 36. Në bazë të dokumenteve që posedon AKP, OP "Borba", OTHPB "Plasman" me seli në Beograd ka pasur Njësi Punuese në Prishtinë, dhe përveç lokalitetit të përshkruar më lartë, ka pasur edhe kioska mirëpo nuk kemi informata se ku janë dhe a ekzistojnë ende.

.Duke marrë parasysh këto, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Palët e pakënaqura me këtë vendim mund të parashtrojnë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2023


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-189/25

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit të PEJ014 NSh Produkt (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit të PEJ014 NSh Produkt (në likuidim) nga Rajoni i Pejës.

Raporti i cili po plotësohet ka qenë raport i shpërndarjes së përkohshme të paraqitur në 28 prill 2016 e të aprovuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr.Ref. BD-73/9, dhe aty ishte ndodh që nuk ishte përfshirë kreditori që është përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, për arsye se kishte parashtruar ankesë në DhPGJSK ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit ndërsa në ndërkohe DHPGJS ka vendosur mbi ankesën e palës me aktgjykimin e Kolegjit të Apelit në mars 2022 dhe pala ka parashtruar kërkesë që të ekzekutohet Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të DhPGJ-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJSK, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmblledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të Likuidimit të PEJ014 NSh "Produkt" (Në Likuidim).

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-189/26

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), neneve 40, 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit të PRN032 NSH Magjistrala (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të likuidimit të PRN032 NSH Magjistrala (në likuidim) nga Rajoni i Prishtinës.

Raporti i cili po plotësohet ka qenë raport i shpërndarjes së përkohshme të paraqitur me 31 gusht 2023 e të aprovuar me vendimin e Bordit të Drejtorëve Nr. Ref. BD-186/30, nuk ishin të përfshirë kreditorët që janë përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, për arsye se nuk kishim informatat e azhurnuara që për të njëjtit janë pranuar aktgjykimet nga Kolegji i Apelit i DhPGJSK-së, për arsye se nuk ishin vendosur dhe nuk ishte bërë ndërrimi i statusit në databazë. Njëmbëdhjetë (11) prej tyre kanë qenë në listën e ankesave (shtojca 8) të paraqitur në muajin gusht 2023, por në ndërkohe prej muajit gusht e deri tani kemi pranuar aktgjykimet nga Kolegji i Apelit dhe për këto njëmbëdhjetë (11) palë dhe andaj janë përfshirë në listën për pagesë në këtë raport plotësues dhe janë larguar nga lista e ankesave (shtojca

Kreditori me numër rendor tre (3) i paraqitur në listën për pagesë (shtojca 3) në këtë raport plotësues, ka qenë i përfshirë edhe në listën për pagesë në raportin e shpërndarjes së përkohshme të paraqitur në gusht 2023 dhe është paguar në bazë të vendimit të AL-së PRN032 – 0114 në shumën prej 94.36 €, pasi që i njëjti nuk ishte i përfshirë në listën e ankesave. Të dhënat në databazë nuk ishin të azhurnuara dhe andaj nuk kemi pasur informata për nxjerrjen e ndonjë aktgjykimi nga DhPGJSK, por përfaqësuesi i autorizuar i palës pasi që ka kuptuar për raportin e shpërndarjes të paraqitur në muajin gusht 2023, ka kontaktuar përmes e-mailit duke dërguar këtë aktgjykim dhe pas verifikimeve të mëtutjeshmë është konstatuar se aktgjykimin AC-I-22-0288 nga Kolegji i Apelit i DhPGJSK është pranuar më datë 22.05.2023 përmes të cilit është vërtetuar aktgjykimin i shkallës së parë me nr. C-IV-22-0070 dt. 04.05.2022 dhe obligohet Autoriteti i Likuidimit që palës të i paguajë shumën prej 3,224.00 Euro + 10% kamatë. Andaj, Autoriteti i Likuidimit e ka përfshirë në listën e raportit plotësues në shumën e aprovuar me aktgjykimin AC-I-22-0288, minus shuma 94.36 € e paguar në raportin e shpërndarjes të paraqitur në muajin gusht 2023.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkesë dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGJSK, dhe poashtu shqyrtimit të analizave përmblledhëse të të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar se ekzistojnë

14/11



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

fonde të mjaftueshme për shpërndarjen plotësuese të përkohshme të fondeve të Likuidimit të PRN032 NSh “Magjistrala” (Në Likuidim).

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtoreve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-189/27

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Rregullorja nr. 16//2023, respektivisht amandamentimi i Rregullores nr. 06/2022 për shitjen direkte të aseteve të caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore;**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e aktit nën ligjor sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Sipas dakordimit në takimin e Bordit të datës 31 gusht 2023 ka ardhur deri te nevoja për plotësim/ndryshimet për të akomoduar dhe rregulluar shqyrtimin kërkesave për shitje direkte të cilat i përkasin një zone të banimit do të shqyrtohen kolektivisht si raste të veçanta me ç'rast rendi kronologjik nuk do të zbatohet. Po ashtu janë bërë ndryshimet tjera për forcimin e kontrolleve të procesit të shitjes direkte.

Po ashtu janë bërë harmonizimet me strukturën e re organizative dhe Rregulloren nr.05-2023 për organizimin e brendshme dhe sistematizimin e vendeve të punës që është në fuqi që nga data 01 tetor 2023.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-189/28

Në bazë të neneve 2.1, 6.2, 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), 18.1.3 të Shtojcës së po të njëjtit Ligj dhe nenit 3.13.1 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, dhe Nenit 252 – 260 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit sipas kërkesës së KK Lipjan për ndërmarrjen e veprimeve në lidhje me objektet e vjetra të ndërtuara në parcelat 094-0 dhe 096-0 ZK Magure, pronë e NSH MIM Goleshi për shkak të rrezikshmërisë së lartë të këtyre objekteve, kështu që kërkohet dhe në të njëjtën kohë i lejohet KK Lipjan që të bëjë rrënimin e këtyre objekteve dhe pas rrënimin të bëjë pastrimin e gjithë hapësirës në parcelat 094-0 dhe 096-0 ZK Magure.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për aprovim të kërkesës së Komunës së Lipjanit në lidhje me asetet (objektet e vjetra) të NSH MIM Golesh PRN053 në Magurë, Lipjan, ku kërkohet ndërmarrja e veprimeve nga ana e AKP-së për arsye se këto objekte paraqesin rrezik të lartë për banorët e asaj zone, e sidomos për fëmijët të cilët i shfrytëzojnë këto objekte për të luajtur.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktin se KK Lipjan kërkesën e ka përsëritur disa herë dhe ka vënë në pah kërkesën për rregullimin e gjendjes dhe mosrrezikim të qytetarëve.

Rrezikshmëria është konstatuar edhe nga Komisioni Komunal Profesional për vlerësimin e rrezikshmërisë, ku është konstatuar se këto objekte janë të dëmtuara në masë të madhe dhe paraqesin rrezik të madh të shembjes dhe kështu rrezikojnë jetën e banorëve përreth e në veqanti të fëmijëve, të cilët këto objekte i shfrytëzojnë për të luajtur sepse ndodhet në afërsi të shkollës në fshatin Magure, Lipjan. Një pjesë e këtyre objekteve përdoret si deponi bërllogu dhe poashtu rrezik edhe shëndetin e banorëve të zonës përreth.

Poashtu ky vendi është marrë duke pasqyruar se kështu do të evitohet shkaktimi i ndonjë rreziku, i cili do mund të kishte pasoja fatale dhe për më tepër do të eliminohej edhe përgjegjësia e AL/AKP-së në rast se paraqitet ndonjë rrezik i paralajmëruar sipas raportit të vlerësimit të rrezikshmërisë.

Duke marrë parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-189/29

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit për Shqyrtimin e KPS-ve, i datës 15.09.2023 lidhur me statusin juridik të aseteve:**
KPS/SDR-1537U/PRN193, Ndërmarrja Organizatë e Punës "Nacional" Beograd, asetet në Prishtinë/Kosovë.
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave për Përcaktimin e Statusit të Entiteteve (KPS), ku sipas tijë bazuar në nenin 5.1.1.2, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 04/L034, si dhe provave të dokumentuara në dosjen të lëndës asetet e Ndërmarrjes Organizatë e Punës "Nacional" në Prishtinë, janë ndërtuar me mjete shoqërore dhe si te tilla kanë funksionuar deri në vitet e 90-ta, andaj rrjedhimisht konform nenit 5 të Ligjit të AKP-së, janë në pronësi shoqërore dhe bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 30 tetor 2023


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-189/30

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenin 10.1.3 të Rregullores nr. 07/2023 për qiradhënien e aseteve të NSH-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) për qiradhënie direkte të Motelit i cili ndodhet në parcelën nr.3105-0, ZK Banjskë, e cila ngastër ka sipërfaqen prej 8 ari 92 m2, pronë e NSH Trepça Standard, me vlerë të përgjithshme prej 200 € në muaj për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e kërkesës për aprovimin e qiradhënies direkte për pronën e NSH "Trepça Standard" Mitrovicë e Veriut sipas kërkesës së Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB).

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se me datë 26 tetor 2023 kemi pranuar kërkesë nga MPB, përmes së cilës kërkojnë që të iu jepet me qira prona e lartëcekur, ku shfrytëzimi i kësaj prone do të bëhet për nevojat të zyrtarëve policor, meqenëse MPB-ja nuk posedon një kompleks (Banjë) të tillë, dhe që për nevojat e zyrtarëve policor në Banjë për trajtim dhe rehabilitim për shkak të natyrës së punës që e kanë, MPB shpenzon buxhet. Vizita në teren për këto prona është realizuar nga Zyra Rajonale e AKP-së në Mitrovicë ku sipas gjendjes në teren Moteli i cili ndodhet në parcelën nr. 3105-0 nuk shfrytëzohet nga askush, ndërsa Restoranti cili ka qenë i ndërtuar në parcelën nr. 3111-0, që ka qenë pronë e NSH-së është rrënuar dhe në këtë ngastër është ndërtuar një objekt nga një palë private, pa pëlqimin e AKP-së.

Sipas vlerësimit të AKP-së, lidhja e Kontratës së Qirasë me parashtruesin e kërkesës do të mundësonte inkasimin e të hyrave mujore si dhe mirëmbajtjen e objektit duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-189/31

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, nenet 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, nenin 3.13.1 të Rregullores për Politikën dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, neni 5.7 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Marrëveshjen e ndërmjetësimit në çështjen penale P.nr. 121/17, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtri i datës 23.02.2023, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 tetor 2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit për aprovimin e çmimit të qirasë të përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues për ngastrën kadastrale nr. 0474-0 ZK Vushtri, pronë e NSH "Elan" MIT012, sipas përcaktimit të çmimit të qirasë me vlerë të përgjithshme prej € 360.96 për një vit.**
- I. **Obligohet pala shfrytëzuese, Ilmi Zeqiri, që sipas Marrëveshjes së Ndërmjetësimit P.nr. 203/18 dhe ND 52/2023 të aprovuar edhe me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtri më datë 26.05.2023 dhe në pajtim me nenin 5.7 dhe 5.8 të Udhëzuesit për lirim të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, të paguajë shumën e qirasë të përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues për periudhën e shfrytëzimit Janar 2001 deri më Tetor 2023 në shumën totale prej € 7,941.12.**
- II. **Sipas Marrëveshjes së Ndërmjetësimit, detyrohet pala shfrytëzuese që shumën prej € 7,941.12 ta paguajë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit mbi vendimin e Bordit të Drejtorëve.**

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoriteti të Likuidimit për aprovimin e kërkesës për aprovimin e Raportit të Komisionit Vlerësues për pronën e NSH "Elan" MIT012, si bazë të Marrëveshjes për Ndërmjetësim për zbatimin e Aktvendimit numër P.nr. 203/18 të aprovuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtri.

Vendimi u aprovua duke u bazuar në faktin se me datën 31.01.2012 Agjencia Kosovare e Privatizimit ka paraqitur kallëzim penal ndaj palës Ilmi Zeqiri për uzurpim të paligjshëm të ngastrës kadastrale nr. 0474-0 ZK Vushtri me sipërfaqe prej 3.76.47 m2 pronë e NSH "Elan" MIT012. Ngastra kadastrale përkatëse ka gjithsej 58034 m2, por është në komasacion. Me datë 26.05.2023 Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega Vushtri me aktvendimin e nxjerrë gjatë seancës gjyqësore kishte vendosur që çështjen penale P.nr. 203/18 ta referojë për ndërmjetësim me nr: ND 52/2023. Me datë 03.03.2023 përfaqësuesja e AKP-së ka pranuar draftin e ndërmjetësimit për shqyrtim dhe nënshkrim dhe bazuar në këtë marrëveshje të ndërmjetësimit pala B (cekur në marrëveshjen e ndërmjetësimit) obligohet që të i paguajë Agjencisë Kosovare të Privatizimit çmimin e përcaktuar nga ana e Komisionit Vlerësues dhe të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve për periudhën e shfrytëzimit prej 01.01.2001 deri më 31.12.2023.

Sipas vlerësimit të AL-së, aprovimi i çmimit të qirasë për ngastrën kadastrale nr. 0474-0 ZK Vushtri me sipërfaqe prej 376.47 m2, i cili do të mirret si referencë për kompensim të qirasë vjetore për tokë bujqësore për periudhën retroaktive prej 01.01.2001 deri në 30.12.2023 të shfrytëzimit nga ana e palës Ilmi Zeqiri, do të



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

mundësonte inkasimin e të hyrave duke rezultuar me rritjen e ndjeshme të fondeve të Ndërmarrjes Shoqërore dhe në këtë rast do të rezultonte me zbatimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit në çështjen penale P.nr. 203/18 dhe ND 52/2023. Është shënuar deri më datë 30.12.2023 për arsye se pala edhe këtë vit e kishte shfrytëzuar për mbjelljen e kulturave bujqësore para nënshkrimit të marrëveshjes dhe tanimë ato kultura bujqësore janë korrur dhe parcela është liruar nga pala sipas informatave nga zyrtari i rastit.

Edhe pse kjo nuk do të jetë një kontratë e qirasë për periudhën e tanishme por do të kërkohej kompensimi për shfrytëzimin për periudhën retroaktive të lartëcekur, Bordi vendosi për aprovimin e çmimit të qirasë të përcaktuar nga Komisioni Vlerësues i përcaktuar me vendimin nr. 717/2023 të datës 11/08/2023. Pala Ilmi Zeqiri sipas marrëveshjes së ndërmjetësimit P.nr. 203/18 dhe ND 52/2023 obligohet dhe në këtë rast zotohet që të paguaj tërë çmimin si kompensim të qirasë, të përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues për periudhën e shfrytëzimit në mënyrë të paligjshme për periudhën Janar 2001 deri në Dhjetor 2023.

Çmimi i përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues për ngastrën kadastrale nr. 0474-0 ZK Vushtrri me sipërfaqe prej 3.76.47 m² pronë e NSh "Elan" MIT012 është 360.96 €/vit për tokë bujqësore. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh periudhën e shfrytëzimit prej 2001 deri në 2023, pala Ilmi Zeqiri do të jetë i obliguar të paguaje shumën totale prej € 7941.12 (360.96 x 22 vite=7941.12).

Pas aprovimit të këtij çmimi nga ana e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Autoriteti i Likuidimit do të njoftojë palën dhe të kërkojë që siç parashihet edhe në marrëveshjen e ndërmjetësimit të paguajë çmimin prej €7941.12 brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit. Në qoftë se pala nuk do të i përmbahet kërkesës së Autoritetit të Likuidimit dhe të zbatojë marrëveshjen e arritur të ndërmjetësimit, atëherë siç parashihet edhe në marrëveshjen e ndërmjetësimit, Autoriteti i Likuidimit i NSh "Elan" MIT012 do të iniciojë procedurë përmbartimore ndaj palës.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 30 tetor 2023.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

